



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:284818

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05805349

PKR.nr.166/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtari Alban Ajvazi, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionistë Avni Sylja dhe Sulltane Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të akuzuarit SH.H, për shkak veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.74K/2021 të datës 30.03.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur, me datës 22.04.2024. në prezencën e Prokurores së shtetit Bukurije Gjonbalaj, të akuzuarit SH.H me mbrojtësin e tij av. Arbër Jupolli sipas autorizimit, me datë 24.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH.H, nga i ati R. dhe ëma S., e gjinisë Q., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna Obiliq, me vendbanim në ..., me nr. personal ..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 par.1, pika 1.3 të KPPRK-së,

LIROHET NGA AKUZA

I

Sepse:

I pandehuri SH.H në cilësinë e personit zyrtarë, si zyrtarë përgjegjës i Prokurimit në Komunën e Obiliqit, me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshëm pasurore për veti apo për tjetrin ka keqpërdorë detyrën zyrtare, duke nënshkruar me datë 24.05.2019 kontratën me numër 027/2019, sipas tenderit me numër identifikues OB614-19-2077-5-2-1, me titull të projektit “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dardhishtë dhe Mazgit” të lidhur në mes të Autoritetit Kontraktues, Komunës së Obiliqit dhe kontraktuesin F.I, përfaqësues i grupit të Operatorëve Ekonomik “G...” SH.P.K, “D...”, SH.P.K dhe “I...” SH.P.K, në vlerë prej 447.833,03 euro, edhe pse operatori ekonomik “D...”, SH.P.K. nuk ka pas të drejt të marr pjesë në aktivitetin e prokurimit ose në ekzekutimin

e kontratës publike, pasi qe pronari i kësaj kompanie E.S ka qenë i dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda sipas aktvendimit të plotfuqishëm të datës 19.04.2018 - Aktgjykimit PKR.nr.271/2015 të datës 19.05.2017, kështu qe duke vepruar në kundërshtim me nenin 65 par.3 të Ligjit nr.04/L-042, të Prokurimit publik të Kosovës, ka lidh kontratën e lartcekur me ç'rast e ka keqpërdorë detyrën zyrtare, duke i mundësuar personit tjetër-E.S dobi pasurore të kundërligjshme,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së.

Sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore, të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/I.nr.74K/2021 të datës 30.03.2022, kundër të akuzuarit SH.H, për shkak veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me aktvendimin nën shenjën PKR.nr.166/22 të datës 31.05.2023, ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave të ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, me datën 06.02.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku kanë prezantuar prokurorja e shtetit Shenaj Berisha, i akuzuari SH.H me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. Arbër Jupolli dhe dëshmitarja H.D, ku i akuzuari në bazë të nenit 319 të KPPRK-së, është udhëzuar me të drejtat e tij ligjore dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari është udhëzuar në bazë të nenit 321 par.1 të KPPRK-së, mbi të drejtat për deklarimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, ku i akuzuari është deklaruar i pafajshëm lidhur me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së.

Në prani të këtyre rrethanave, Gjykata ka vazhduar me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, ku janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datën: 06.02.2024, 12.03.2024 dhe 22.04.2024, në të cilat është dhënë fjala hyrëse e palëve, gjithashtu për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka dëgjuar dëshmitarët: H.D, N.SH, S.H, V.B, E.S, F.I, D.H, O.K, gjithashtu në këtë çështje penale është bërë administrimi i provave materiale, është dhënë mbrojtja e të akuzuarit si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurorja e shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: me aktakuzën me PP/I.nr.74K/2021 të datës 30.03.2022 i akuzuari SH.H është akuzuar për veprën penale

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, nga provat e siguruara n; procedurën hetimore dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike në bazë të së cilës qartë dhe bindshëm vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Nga deklarata e dëshmitares H.D vërtetohet se e njëjta ka qenë anëtare e komisionit për verifikim si anëtare e komisionit bëhet vetëm vlerësimi sipas çmimit dhe dokumentacionit teknik dhe jo ato juridik, për dokumentacionin se personi nuk është i dënuar përgjegjës është zyra e prokurimit e jo komisioni vlerësues, gjithashtu kjo vërtetohet edhe nga deklarata e anëtareve të tjerë siç janë S.H dhe N.SH të cilët thonë se dokumentin se personi ka qenë i dënuar apo jo duhet ti kërkoj zyra e prokurimit e jo komisioni vlerësues, dëshmitarja F.B ka deklaruar se punon në zyrën e prokurimit ka qenë prezentë gjatë vlerësimit nga ana e anëtareve të komisionit lidhur me tenderimin e rrugës së fshatit Mazgit ku kompanitë në koncerzium G... sh.p.k, D... sh.p.k dhe Ispe. sh.p.k, kanë qenë fitues të këtij tenderi, certifikatat nga gjykata nuk i ka pasur asnjë kompani tenderuese sepse këtë dokument e kërkon zyra e prokurimit para se të nënshkruhet kontrata e jo komisioni vlerësimit kështu që gjatë fazës së vlerësimit nuk kërkohet ky dokument. Nga dëshmia e dëshmitarit E.S vërtetohet se i njëjti ka qenë pronar i kompanisë D... sh.p.k, i njëjti ka aplikuar me datën 12.04.2021 ka aplikuar në koncerzium me dy kompani G... dhe ispe, për asfaltimin e rrugës në fshatin Dardhishtë dhe Mazgit, gjithashtu nga deklarata e këtij dëshmitari vërtetohet se zyra e prokurimit e ka ditur se ka qenë i dënuar, për faktin se kjo zyre sepse i njëjti ka qenë i dënuar po nga kjo komunë, përveç zyrës së prokurimit vërtetohet se i njoftuar me këtë ka qenë edhe kryetari. Nga dëshmia e dëshmitarit F.I vërtetohet se i njëjti ka firmën Graniti sh.p.k dhe në koncerzium me kompaninë D... dhe Ispe ka fituar tenderin për rrugën Dardhishtë dhe Mazgit nuk e ka ditur se ndonjëri nga pronaret ka qenë i dënuar dhe me rastin e nënshkrimit të tenderit askush nuk ja ka kërkuar këtë dokument, dëshmitari O.K si menaxher i projekti deklaroi se nuk ka qenë në dijeni se pronari i kompanisë i cili ka fituar projektin ka qenë i dënuar gjithashtu dëshmitarja D.H ka deklaruar se askush nuk e ka kërkuar nga zyra e prokurimit ndonjë dokument apo sqarim të tillë. Nga administrimi i provave materiale, siç janë: dosja e tenderimit në pjesën A seksioni 1 janë informacionet për tenderuesin, kërkesa që duhet të plotësohen nga operatorin ekonomik pika 6 përshtatshmëria e operatorit ekonomik kërkesat e përshtatshmërisë pika 6.2, operatori ekonomik nuk ka drejtë të marr pjesë në aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike nëse operatori i tillë ekonomik ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë 10 viteve të fundit është shpallur fajtor për kryerjen e një veprë penale ose civile, nga raporti i vlerësimit të tenderimit vërtetohet se komisioni i vlerësimit ekzaminon vlerëson dhe bënë krahasimin e tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike, në njoftimin për kontratë të datës 12.04.2019 nr. prokurimit OB 614- 19-2077-5-2-1, janë të cekura kushtet në lidhje me kontratën, kushte dhe përmirja, kërkesat e përshtatshmërisë sipas kërkesës nr.1 operatori duhet ti përmbush kërkesat e specifikuar në nenin 65, dëshmitë e kërkuara siç janë dëshmia nr.2, vërtetimi i lëshuar nga gjykata jo me i vjetër se 6 muaj para datës së dorëzimit të tenderit e që duhet të jetë origjinal ose i noterizuar, në kontratën vërtetohet se asfaltimi i rrugës në fshatin Dardhishtë dhe Mazgit me datën 24.05.2019, kontrata e lidhur në mes të pandehurit SH.H zyrtar përgjegjës i prokurimit dhe F.I përfaqësues i operatoreve ekonomik, në këtë bën pjesë edhe operatori D.... me pronar E.S i cili ka qenë i dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Renda, sipas Aktvendimit të plotfuqishëm të datës 19.04.2019, sipas Aktgjykimit PKR nr.271/15 të datës 19.05.2017, kjo vërtetohet se i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale mashtrim nga neni 335 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga gjykata e Apelit me nr. PAKR.nr.417/2017 i datës 19.04.2019, duke analizuar të gjitha provat rezultoi se i akuzuari ka kryer veprën penale, andaj mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e matjes së dënimit ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të njëjtin.

Mbrojtësi i të akuzuarit SH.H, av. Arbër Jupolli në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e kundërshtojmë në tersi aktakuzën e prokurorisë duke konsideruar se e njëjta nuk mbështetet me asnjë provë materiale apo personale e cila do të provonte se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Tek vepra penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, aktakuza duhet që patjetër të dëshmoj me prova dhe saktësisht të përcaktoj se cili veprim zyrtar nuk është ndërmarr apo cili autorizim është tejkaluar sepse kjo është element i veçantë dhe bazë i veprës penale. Pastaj, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejt që nënkupton dijeninë e kryerësit se i njëjti kur e shfrytëzon pozitën apo autoritetin e tij zyrtar po tejkalon kompetencat e tij, duke qenë i vetëdijshëm në inkriminimin e tij penal, dhe këtë i njëjti e kryen me qëllim që vetës apo personit tjetër për interesat e tija ti sjell dobi pasurore apo ti shkaktoj dëm. Elemente këto te cilat në rastin ndaj të mbrojturit tim , nuk janë provuar nga organi i akuzës. Mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor çdoherë e ka vënë theksin tek krijimi i një praktike të përgjithshme vendore në rastin e zbatimit të procedurës së tenderimit madje gjatë fazës së plotësimit Autoriteti të provave Kontraktues i ka parashtruar që në cilësi të provë Njoftim për një dokument, nënshkrimin e kontratës së prokurimit GRA 618-18-5706-5-2-1, të datës 16.10.2018. Në këtë "Njoftim" përshkruhet se kompania "D..." SH.P.K është përzgjedhur si kompani fituese e një tenderi për rikonstruktimin e shkollës fillore në fshatin Batushë, pra pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dënues për përfaqësuesin e kompanisë "D..." E.S. Ky fakt e mbështet argumentin e mbrojtjes se jo vetëm komuna e Obiliqit si autoritet kontraktues por edhe institucionet e tjera qoftë të nivelit lokal apo qendror e kanë pasur si praktikë që sa i përket dokumentacionit ta kërkojnë një certifikatë nga departamenti ekonomik i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me pasqyrën e kompanisë apo insolvencën eventualuale të kompanisë aplikuese, ndërsa sa i përket personave fizik është kërkuar një deklaratë nën betim nga personi i autorizuar i kompanisë aplikuese, procedurë kjo të cilën e ka zbatuar edhe i mbrojturi im në rastin konkret. E që pavarësisht faktin nëse kjo praktikë e të vepruarit ka qenë e gabuar asesi nuk nënkupton inkriminim penal, për shkak se rasti konkret i këtij tenderimi ku pjesëmarrës ka qenë "D..." është trajtuar njësoj sikur çdo rast tjetër i tenderimit. Për të mbështetur me prova pretendimin e mbrojtjes se ka qenë praktik në nivel vendi që të kërkohej vetëm deklarata nën betim i kemi parashtruar gjatë fazës së plotësimit të provave po ashtu ekzemplar të autoriteteve të ndryshme kontraktuese të nivelit lokal apo qendror siç bie fiala dokumenti "Njoftim për kontratë" me numër të Prokurimit 656-19-7140-5-2-1 i datës 19.09.2019, i marrë nga Komuna e Ferizajt si autoritet kontraktues, ku nëse shihet në faqen 4 rubrika e parë djathtas "Dëshmia e kërkuar dokumentare" kërkohej deklarata nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi, e njëjta praktikë është zbatuar edhe nga autoritet tjera kontraktues siç janë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministritë e ndryshme, dhe Komunitat tjera. Pra, mbrojta e dëshmon me prova materiale pretendimin se nuk ka pasur asnjë qëllim favorizimi apo veprimi ndryshe në rastin e procedurës së tenderimit sipas së cilës i mbrojturi im ka nënshkruar kontratën me numër 027/2019. Edhe raporti i datës 15.09.2021- Procesverbal për pranim teknik, përshkruan se Komisioni në bazë të shikimit në vend konstatoi si vijon: Kryerja e punimeve lidhur me projektin " Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dardhishtë dhe Mazgit "është kryer brenda kontratës dhe sipas specifikimeve teknike në Kontratë". Pra fakt tjetër me rëndësi është se nuk ka dëm publik të shkaktuar fakt ky që konstatohet nga raportet zyrtare. Mbi bazën e të lartcekurave në rastin e të mbrojturit tim nuk plotësohet figura e veprës penale për të cilën akuzohet dhe i propozojmë gjykatës që të merr aktgjykim lirues për të njëjtin.

I pandehuri SH.H ka deklaruar se: e përkrahi fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe nuk ka çfarë të shtoj tjetër.

Procedura e Provave

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka dëgjuar dëshmitarët: H.D, N.SH, S.H, V.B, E.S, F.I, D.H, O.K si dhe ka administruar provat materiale si në vijim: dosja e tenderit – procedura e tenderimit, raporti i vlerësimit të tenderit, njoftimi për kontratë i datës 12.04.2019, me numër të prokurimit OB614-19-2077-5-1, kontrata “Asfaltimi i rrugëve fshatin Dardhishte dhe Mazgit” i datës 24.05.2019, ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 20.01.2024, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtine - Departamenti i Krimeve të rënda PKR.nr.271/15, i datës 19.05.2017, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. Nr. 417/2017, i datës 19.04.2018, ekzemplar i autoritetit kontraktues të Komunës Ferizaj me numër të prokurimit 656/19, 756-19-7140-5-2-1, njoftimi për kontratë i autoritetit kontraktues - Këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër të njoftimit 328-19-310-5-1-1, dhe njoftimi për nënshkrimin e kontratës nga autoriteti kontraktues - Komuna e Garancisë me numër të prokurimit GRA 618-18-5706-5-2-1, në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 06.02.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar H.D, e cila ka deklaruar se: lidhur me rastin konkret kemi qenë unë kryetare e komisionit, ndërsa anëtarë kanë qenë S.H dhe N.SH për vlerësimin e dokumenteve të ofruara sipas kriterëve të aplikimit nga kompanitë dhe pas verifikimit kemi vlerësuar se gjithçka ka qenë në rregull, ndërsa sa i përket të kaluarës kriminale për pronaret dhe personat përgjegjës nuk ka qenë detyrë e jona ti vlerësojmë, lidhur me këtë përgjegjës ka qenë kompetentë zyra e prokurimit dhe nuk kam njohuri se a është përmbushur kontrata dhe gjatë vlerësimit tonë nuk kemi pas ndërhyrje apo tentim ndërhyrje nga asnjë person dhe as nga SH.H.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar N.SH, i cili ka deklaruar se: lidhur me vlerësimin e tenderit për asfaltim të rrugës Dardhishtë – Mazgitë, me vendim të kryetarit jam caktuar anëtarë i komisionit të vlerësimit, ku kemi vlerësuar se kompania e i ka mjetet e punës, sigurimin e tenderit, vërtetimin ATK-së dhe vlerësimin punës tri vjeçare, ndërsa lidhur me certifikatën e evidencës penale ajo kërkohet pasi që të rekomandohet fituesi dhe atë e kërkon zyra e prokurimit.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar S.H, i cili ka deklaruar se: lidhur me vlerësimin e tenderit për asfaltim të rrugës Dardhishtë – Mazgitë, me vendim të kryetarit jam caktuar anëtarë i komisionit të vlerësimit, ku kemi vlerësuar dokumentacionin e ofertuesve se a i plotësojnë kushtet ligjore dhe cila është më e lirë në ofertim,

ndërsa gjatë vlerësimit asiston një zyrtar nga zyra e prokurimit publik, ndërsa lidhur me certifikatën e evidencës penale, kjo nuk është punë e jona të shikojmë por e zyrës së prokurimit.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar V.B, e cila ka deklaruar se: gjatë vitit 2019 ka punuar në zyrën e prokurimit në Komunën e Obiliqit, në cilësinë e zyrtares, detyrat e mija të punës kanë qenë shkarkimi i ofertave dhe prezantimi i tyre komisionit dhe gjatë shkarkimit të tyre nuk ka pas certifikatë nga evidenca penale për kompanitë që kanë aplikuar, ky dokument kërkohet vetëm për kompaninë që fiton tenderin dhe plotësohet para nënshkrimit të kontratës nga shefi i prokurimit. Deklarata nën betim kërkohet me ligj dhe e njëjta është obligueshme.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar E.S, i cili ka deklaruar se: kam qenë pronar i kompanisë ndërtimore D... dhe në bashkëpunim me kompaninë G... kam aplikuar në një tender në Komunën e Obiliqit ku e kemi fituar atë, unë e kam pas një dënim të gjykatës si i dënuar, por kam aplikuar në tender sepse kam mendur se kam pas të drejtë me apliku edhe pse kam qenë i dënuar, pasi që kishin kaluar 3-4 vite nga momenti kur jam dënuar dhe nga komuna askush nuk më ka kërkuar dokument për të kaluarën kriminale, ndërsa për deklaratën nën betim nuk e di kush e ka nënshkruar dhe dorëzuar. SH.H-in e kam njofte si emër, por nuk e kam ditë se kush është, pasi që kur nuk e kam takuar dhe për herë të parë po e shoh këtu në sallë të gjyqimit.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar F.I, i cili ka deklaruar se: në vitin 2019 kam qenë pronar i operatori ekonomik G... dhe me këtë firmë kam aplikuar në tender për asfaltimin e rrugës Mazgit - Dardhishtë, sëbashku me tjera si koncerzium, "I..." dhe "D...", të cilin tender e kemi fituar, pasi që i kemi plotësuar të gjitha kushtet, unë nuk e kam ditë që pronari i firmës "D..." ka qenë i dënuar, pasi që të njëjtin nuk e kam takuar, por djalin e tij. Në këtë rast neve nuk na është kërkuar certifikata nga evidenca penale, por edhe në rastet tjera nuk kërkohet.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar D.H, e cila ka deklaruar se: në vitin 2019 në Komunën e Obiliqit, kam punuar në cilësinë e zyrtares ligjore dhe në atë kohë kompania D... e cila kishte aplikuar për tender dhe në atë kohë për pronarin e kësaj kompanie na ka ardhur një aktgjykim, i cili kishte qenë i dënuar, por për të njëjtin nuk ka pasur dënim plotësues që e ndalon këtë firmë të aplikoj në tender, por vetëm jemi udhëzuar për kompensim dëmi, të cilën procedurë edhe e kemi ndjekur.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar O.K, i cili ka deklaruar se: në vitin 2019 kam punuar në Komunën e Obiliqit – Drejtorinë e Infrastrukturës, në cilësinë e zyrtarit të lartë ligjor, lidhur me asfaltimin e rrugës Mazgit – Dardhishtë kam qenë i menaxher i këtij projektit dhe i kam mbikëqyr punimet dhe nuk e kam ditur që një operator ekonomik që e ka fituar tenderin ka qenë i dënuar pasi që kjo çështje nuk është detyrë e imja. Vlerësoj se komuna nuk është e dëmtuar nga punimet e kryera sipas kësaj kontrate.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale administroi edhe provat materiale si në vijim:

Nga dosja e tenderit – procedura e tenderimit, vërtetohen kushtet që duhet të i plotësoj një operator ekonomik në mënyrë që të ketë të drejtë të marrë pjesë në procedurën e tenderimit, ku njëra ndër to është se operatori *nuk ka të drejtë të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik ose ndonjë drejtues,*

menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit është shpallë fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale.

Nga raporti i vlerësimit të tenderit, vërtetohet se komisioni i vlerësimit të tenderëve, ekzaminon, vlerëson dhe bënë krahasimin e tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike, që operatorët ekonomik i plotësojnë kriteret për paanshmërinë e dokumentacioneve.

Nga njoftimi për kontratë i datës 12.04.2019, me numër të prokurimit OB614-19-2077-5-1, vërtetohen kushtet që duhet të i përmbush një operator ekonomik dhe dokumentet e kërkuara me rastin e aplikimi për tender, ku njëra nga dokumentet që kërkohet është e vërtetimi i lëshuar nga gjykata jo më i vjetër se 6 muaj para ditës së dorëzimit të tenderit, origjinal ose i noterizuar.

Nga kontrata “Asfaltimi i rrugëve fshatin Dardhishte dhe Mazgit” i datës 24.05.2019, vërtetohet se kontrata është lidhure në mesë të pandehurit SH.H - zyrtarë përgjegjës i prokurimit dhe F.I, përfaqësues i grupit të Operatorëve Ekonomik “G...” SH.P.K, “D...” SH.P.K dhe “I...” SH.P.K, ku në këtë grupe bënë pjesë edhe OE “D...”, SH.P.K me pronar E.S.

Nga ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 20.01.1024, vërtetohet se i pandehuri SH.H me datë 20.01.2014, transferohet në mënyrë të përhershme në vendin e punës Menaxher i Prokurimit në Drejtorinë për administratë të përgjithshme në Komunën e Obiliqit.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.271/15, i datës 19.05.2017, vërtetohet se vërtetohet se pronari i OE “D...”, E.S është shpallur fajtorë sepse në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Mashtrim nga neni 335 par.3 lidhur me par.2 dhe lidhur me 31 të KPRK-së.

Nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.Nr.417/2017, të datës 19.04.2018, vërtetohet se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.271/15, i datës 19.05.2017, është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga ekzemplar i autoritetit kontraktues të Komunës Ferizaj me numër të prokurimit 656/19, 756-19-7140-5-2-1, vërtetohet se ky institucion gjatë procedurave të prokurimit, te rubrika e dokumenteve të kërkuara, ka kërkuar edhe deklaratën nën betim të nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e caktuar nga dosja e tenderit.

Nga njoftimi për kontratë i autoritetit kontraktues - Këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër të njoftimit 328-19-310-5-1-1, vërtetohet se ky institucion gjatë procedurave të prokurimit, te rubrika e dokumenteve të kërkuara, ka kërkuar edhe deklaratën nën betim të nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e caktuar nga dosja e tenderit.

Nga njoftimi për nënshkrimin e kontratës nga autoriteti kontraktues - Komuna e Garancisë me numër të prokurimit GRA 618-18-5706-5-2-1, vërtetohet se ky institucion gjatë procedurave të prokurimit, te rubrika e dokumenteve të kërkuara, ka kërkuar edhe deklaratën nën betim të nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e caktuar nga dosja e tenderit.

Pas deklarimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i akuzuari ka paraqitur mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor.

I akuzuari SH.H ka shfrytëzuar të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje.

Gjetjet e gjykatës

Faktet jo kontestuese:

Nga të gjitha provat materiale të administruara për gjykatën nuk është kontestuese fakti se i akuzuari SH.H në cilësinë e personit zyrtar ka qenë zyrtarë përgjegjës i prokurimit në Komunën e Obiliqit, nuk ishte kontestuese fakti se i njëjti me datë 24.05.2019 ka nënshkruar kontratën me numër 027/2019, sipas tenderit me numër identifikues OB614-19-2077-5-2-1, me titull të projektit “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dardhishtë dhe Mazgit” të lidhur në mes të Autoritetit Kontraktues, Komunës së Obiliqit dhe kontraktuesin F.I, përfaqësues i grupit të Operatorëve Ekonomik “G...” sh.p.k, “D...”, sh.p.k dhe “I...” sh.p.k, në vlerë prej 447.833,03 euro, nuk ishte kontestuese se përgjegjëses për vlerësimin e dokumentacionit për aplikim të kompanive tenderuese ka qenë i akuzuari SH.H, po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se pronari i kompanisë “D...” sh.p.k në momentin e aplikimit për tender ka qenë i dënuar nga gjykata.

Faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes të palëve. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë: H.D, N.SH, S.H, V.B, si dhe nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë: dosja e tenderit – procedura e tenderimit, raporti i vlerësimit të tenderit, njoftimi për kontratë i datës 12.04.2019, me numër të prokurimit OB614-19-2077-5-1, kontrata “Asfaltimi i rrugëve fshatin Dardhishtë dhe Mazgit” i datës 24.05.2019, ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 20.01.1024, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të renda PKR.nr.271/15, i datës 19.05.2017, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. Nr. 417/2017, i datës 19.04.2018.

Faktet Kontestuese:

Kontestuese ishte për gjykatën fakti nëse i akuzuari ka pas për obligim, para nënshkrimit të kontratës së tenderit, të kërkoj nga fituesi i tenderit që t’ia bashkëngjisë dokumenteve edhe vërtetimin nga gjykata mbi evidencën penale, siç e parasheh edhe ligji për prokurimin publik neni 65 par.3 si dhe në kushtet e kontratës.

Faktet kontestuese gjykata i ka zgjidhur pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dhe analizimit të elementeve të veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjykata vërtetoi faktin se i akuzuari është dashur të kërkoj vërtetimin mbi evidencën penale nga ana e fituesit të tenderit, kjo vërtetohet edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë: H.D, N.SH, S.H, V.B, nga dosja e tenderit si dhe nga dispozita ligjore nga neni 65 par.3 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Mirëpo në rastin konkret edhe pse i akuzuari nuk e ka kërkuar këtë vërtetim nga evidencat penale nga ana e fituesit të tenderit, gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me mos përmbushje të detyrave të punës, e të cilat mund të trajtohen në procedurat tjera brenda institucionit.

Nga vlerësimi i deklaratës së dëshmitarit E.S, gjykata vërtetoi se me rastin e fitimit të tenderit, nuk është kërkuar vërtetimi nga gjykata mbi evidencën penale nga zyra e prokurimit dhe se i njëjti asnjëherë nuk ishte takuar me të akuzuarin dhe se për herë të parë e kishte takuar në sallën e gjykimit, po ashtu një pjesë e deklaratimit të tij është në përputhje me deklaratimin e dëshmitarit tjetër F.I, i cili kishte deklaruar se me rastin e fitimit të tenderit nuk i’u kërkuar vërtetimi nga

gjykata mbi evidencën penale në këtë rast po as në rastet tjera kur kanë fituar tender tjerë. Nga vlerësimi i deklaratës së dëshmitares D.H gjykata vërtetoi se aktgjykimi me të cilin është shpallë fajtorë pronari i kompanisë “D...” nuk ka pasur dënim plotësues që e ndalon këtë firmë të aplikoj për tender. Po ashtu gjatë vlerësimit të deklaratës së dëshmitarit O.K gjykata vërtetoi se Komuna e Obiliqit në këtë rast nuk është e dëmtuar nga punimet e kryera sipas kontratës në fjalë, pra në këtë rast me veprimet e të akuzuarit nuk është shkaktuar dëm. Gjykata po ashtu vlerësoi edhe provat materiale, siç janë ekzemplari i autoritetit kontraktues të Komunës Ferizaj me numër të prokurimit 656/19, 756-19-7140-5-2-1, njoftimi për kontratë i autoritetit kontraktues - Këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër të njoftimit 328-19-310-5-1-1, dhe njoftimi për nënshkrimin e kontratës nga autoriteti kontraktues - Komuna e Garancisë me numër të prokurimit GRA 618-18-5706-5-2-1, në të cilat rezulton se as institucionet tjera me rastin e shpalljes së njoftimi për kontratë nuk kërkojnë vërtetim nga gjykata, por në shumicën e rasteve obligative si dokument është deklarata nën betim e nënshkruar nga tenderuesi, duke e përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. Provave të lartcekura gjykata i’a falë besimin pasi që të njëjtat ishin në lidhshmëri me njëra tjetrën, kredibile të besueshme dhe në përputhshmëri të plotë me provat tjera dhe gjendjen faktike si në aktakuzë.

Nga të gjitha këto rrethanë për gjykatën rezulton se provat që mbështesin aktakuzën nuk krijojnë dyshimin e bazuar për elementet e veprës penale për të cilën akuzohet i njëjti, me saktësisht me asnjë prove që prokuroria e mbështet aktakuzën nuk rezulton ekzistimi i dyshimit të bazuar mirë dhe as nga faktet e çështjes nuk rrjedh ekzistim i ndonjë qëllimi që përmes ushtrimit të autorizimit e tij si zyrtarë përgjegjës i prokurimit në Komunën e Obiliqit, i akuzuari të ketë pasur qëllim të përfitimit për vete apo personit tjetër apo shkaktimit të dëmit.

Gjykata vlerëson se me veprime e të akuzuarit, kemi të bëjmë me mos përmbushje të detyrave të punës brenda institucionit ku ka punuar, pasi që nuk përmbushen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet.

Vështruar nga cilësimi juridik i veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër.

Në rastin konkret lidhur me të akuzuarin SH.H, nga provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës e të cilat janë propozuar të administrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk rezulton dyshimi i bazuar mirë se i njëjti ka keqpërdor detyrën zyrtare, ashtu që të ketë tejkaluar kompetencat e tij ose nuk i ka përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim të përfitimi ndonjë dobi pasurore për veti apo personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, kjo pasi që i akuzuari akuzohet se në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete apo tjetrin nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare ashtu që i njëjti si person përgjegjës i prokurimit në Komunën Obiliqit ka nënshkruar kontratë sipas tenderit, mes të Autoritetit Kontraktues, Komunës së Obiliqit dhe kontraktuesin F.I, përfaqësues i grupit të Operatorëve Ekonomik edhe pse operatori ekonomik “D...”, SH.P.K. nuk ka pas të drejt të marr pjesë në aktivitetin e prokurimit ose në ekzekutimin e kontratës publike, pasi që pronari i kësaj kompanie E.S ka qenë i dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve.

Prokuroria në aktin akuzues nuk ka arritur që t’i provojë elementet e kësaj veprë penale mbi bazën e të cilave i akuzuari i ka ndërmar për tu konsumuar kjo veprë penale.

Elementi kryesor i kësaj vepre penale, elementi i dashjes, sipas kësaj aktakuze dhe provave të bashkangjitura nuk është vërtetuar se i akuzuari me veprimet e tij, ka dashur që të përfitojë për vete apo personin tjetër apo që të i shkaktojë dëme personit tjetër duke mos e kërkuar vërtetimin mbi evidencën penale nga kompania që e ka fituar tenderin që është objekt i akuzës, pasi që i njëjti në mesin e dokumenteve të kërkuara, kishte qenë edhe deklarata nën betim e nënshkruar nga tenderuesi, duke e përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Prandaj, gjykata këtu nuk ka gjetur lidhjen kauzale në mes të akuzuarit SH.H dhe personit F.I - përfaqësues i grupit të OE si dhe pronarit të OE "D..." sh.p.k – E.S, apo personave tjerë, ashtu që të vije në shprehje dashja si element i kësaj vepre për përfitim për vete apo tjetrin.

Mos kërkimi i vërtetimit mbi evidencën penale nga kompania që e kishte fituar tenderin, gjykata vlerëson me këtë veprim kemi të bëjmë më mos përmbushje të detyrave dhe obligime të punës që kanë qenë kompetence e të akuzuarit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate veprimet e të akuzuarit, ishin veprime të paligjshme, për faktin se nuk e ka kërkuar vërtetimin për të kaluarën kriminale, mirëpo jo çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare, nënkupton edhe veprën penale nga neni 414 par.1 të KPRK-së, veprimi i paligjshëm mund të jetë: delikt civil, kundërvajtje, delikt administrativ, kjo për faktin se vepra penale e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit dhe detyrës zyrtare, në njërin nga tri variante e saja parashihet: 1. keqpërdorimi, 2. tejkalimi i kompetencave dhe 3. mosndërmarrja e veprimeve, mund të kryhet vetëm me dashje, ku element qenësor i veprës penale është qëllimi, për përfitim material për veten ose tjetrin, apo për ti shkaktuar dëm dikujt, në rastin konkret i akuzuari nuk kishte qëllim, përfitim as dëm, këto element qenësor, pa të cilën nuk ka vepra penale dhe nuk e ka provuar me asnjë provë prokurori në akuzën e tij. Kjo veprë penale, ekziston kur: personi zyrtar ndërmer veprime të cilat formalisht janë në kuadër të autorizimeve të tij, por ato janë të kundërligjshme në aspektin material, ngase janë në kundërshtim me interesat dhe detyrat e shërbimit. Me veprimin e tij, kryerësi i lë pas dore interesat dhe qëllimet e shërbimit dhe ato i zëvendëson me interesat e veta ose interesat e ndonjë personi tjetër. Ai detyrën dhe autorizimin e tij e shfrytëzon për t'i sjellë vetes a tjetrit dobi pasurore ose për t'i shkaktuar dëm tjetrit.

Po ashtu gjykata nga provat e administruara të propozuara nga ana e mbrojtjes, siç janë: ekzemplari i autoritetit kontraktues të Komunës Ferizaj me numër të prokurimit 656/19, 756-19-7140-5-2-1, njoftimi për kontratë i autoritetit kontraktues - Këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër të njoftimit 328-19-310-5-1-1, dhe njoftimi për nënshkrimin e kontratës nga autoriteti kontraktues - Komuna e Garancisë me numër të prokurimit GRA 618-18-5706-5-2-1, vërtetohet fakti se është bërë praktik edhe nga institucionet tjera se nuk kërkohet vërtetimi për të kaluarën kriminale, mirëpo është mjaftueshme deklarata nën betim, që edhe në rastin konkret e njëjta ka ndodhë.

Gjithashtu gjykata, vlerëson se nga provat e administruara, gjegjësisht nga përfaqësuesi i Komunës së Obiliqirt, të cilët kanë deklaruar se në rastin konkret nuk jemi palë të dëmtuar dhe se punimet lidhur me këtë projekt kanë përfunduar në mënyrë të paraparë me kontratë, ku është bërë realizimi i të gjitha punëve dhe pagesave në mënyrë të rregullt, gjithashtu me rastin e shpalljes fituese të kompanisë nuk ka pas ankesë lidhur me këtë, andaj konsiderojmë se lidhur me këtë nuk ka dëme të shkaktuar, që është element i veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari.

Gjykata thekson faktin se në rastin konkret Prokuroria është dashur t'i referohet në mënyrë të saktë dhe të qartë veprimit të kryerjes së veprës penale dhe në këtë mënyrë të vërtetoj dashjen direkte të të akuzuarit në drejtim të kryerjes së veprës penale duke u bazuar në prova të qarta, konkrete dhe bindëse për gjykatën dhe jo që përshkrimin faktik në dispozitivin e Aktakuzës ta lërë të paqartë dhe të pasqaruar. Vepra penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, kryhet vetëm me “dashje të drejtpërdrejtë” e që përfshin dijeninë e kryesit se i njëjti nuk po e kryen detyrën zyrtare dhe se po i shkakton dëm personit tjetër. “Dashja” sipas nenit 21 të KPRK-së, konsiderohet se kryesi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe ka dashur që ta kryejë, apo kur ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit të tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, por e ka pranuar, është dakorduar që të shkaktohet ajo pasojë, e në rastin e “dashjes direkte”, ekziston atëherë kur kryesi është i vetëdijshëm se me veprimin apo mosveprimin e vet do të kryejë vepër të dëmshme, vepër penale dhe dëshiron kryerjen e asaj vepre, dëshiron që të shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme. Gjykata, duke pasur parasysh që i akuzuari në këtë rast akuzohet për një vepër penale e cila kryhet me “dashje të drejtpërdrejtë-direkte”, e njëjta nuk ka mundur që përmes provave të ofruara nga Prokuroria dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të vërtetoj se tek veprimet e të akuzuarit ka ekzistuar elementi i “dashjes të drejtpërdrejtë-direkte”.

Gjykata vlerësoi pretendimet e Prokurorisë, por e njëjta nuk arriti që t'i argumentoj me fakte dhe prova bindëse para gjykatës elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari, ngase nga provat e administruara nuk u gjet se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë trupi gjykues pasi analizoi provat materiale dhe bazën ligjore, nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet e veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, andaj në mungesë të provave, e në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, të akuzuarin e liroi nga akuza.

Në këtë rast gjykata në aplikim të nenit 3 par.2 të KPPRK-së, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite i interpreton në favor të akuzuarit, e që në rastin konkret të gjitha mëdyshjet e paraqitura në vlerësim të gjendjes faktike e të cilat nuk u vërtetuan përtej dyshimit të bazuar mirë, i mori në favor të akuzuarit.

Prandaj sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret me provat e propozuara dhe të zbatuara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 462 par.3 të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe në bazë të nenit 363 par.1, pika 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.166/22, datë 11.06.2024

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.